

KOMPANIA PËR PRODHIM DHE SERVISIM TË TRANSFORMATORËVE



# Aulona

Sh.p.k.



Gjakovë, Kosovë






## TRANSFORMATORI ENERJETIK DISTRIBUTIV (TEDA):

Është prodhim ekskluziv i kompanisë “Aulona” Shpk nga Gjakova, i cili ju garanton rezultate shumë të mira në: jetëzgjatje maksimale; stabilitet në punë; humbje shumë të vogla të energjisë në punë me dhe pa ngarkesë; zhurmë të vogël; si dhe ruajtje të ambientit në maksimum nga ndotjet. “Aulona” Shpk prodhon transformator të tensioneve 10/0,4 kV; 10/0,42 kV; 20/10/0.4 kV dhe 20/0,4 kV të gjitha për fuqitë nga 50 kVA e gjër në 1000 kVA. Transformatorët janë të paraparë për montim të jashtëm dhe të mbrendshëm; ftohje me vaj transformatori; me konzervator të jashtëm; të mbrendshëm dhe pa konzervator, të cilët prodhohen dhe atestohen sipas standardit IEC 600076.



KUSHTET TEKNIKE PËR PRODHIMIN E TRANSFORMATORIT TREFAZOR ENERGJETIK  
DISTRIBUTIV TIP TEDA ME KONZERVATOR SIPAS STANDARDIT IEC 60076

Fuqia nominale	kVA	50	100	160	250	400	630	1000
Tensioni nominal	kV	20/ 10/ 0,4 kV						
Rregullimi		$\pm 2 \times 2,5\%$						
Frekuenca	Hz	50 Hz						
Grupa vektoriale e lidhjes		Yzn5	Yzn5	Yzn5	Dyn5	Dyn5	Dyn5	Dyn5
Toleranca në raportin e transformimit	%	4	4	4	4	4	4	6
Humbjet dhe rryma e punës pa ngarkesë	W	150	250	360	520	740	1050	1330
Humbjet me ngarkesë dhe tensioni I lidhjes së shkurtër	W	850	1450	1850	2600	3650	5200	9000
Lloji I ftohjes		ONAN						
Sasia e vajit	kg	135	180	235	310	390	525	680
Pesha e tërsishme	kg	560	720	820	1105	1490	2350	2985



- 1 IZOLATORI I TL
- 2 IZOLATORI I TU
- 3 KONZERVATORI
- 4 VESHËT PËR NGRITJE
- 5 RROTAT
- 6 LËSHUESI I VAJIT
- 7 NDERRUESI ( $\pm 2 \times 2,5\%$ )
- 8 XHEPI PËR TERMOMETËR (50+400 kVA)
- 9 RELEJA E GAZIT
- 10 RREGULLATORI (21/10.5kV)
- 11 TREGUESI MAGNETIK I VAJIT
- 12 THARËSI I AJRIT

DIMENSIONET E TRANSFORMATORIT TEDA

Lartësia	C	1350	1420	1495	1670	1785	1940	2130
Gjërësia	B	620	630	650	685	730	750	1200
Gjatësia	A	940	985	1060	1130	1500	1600	2000
Distanca në mes rrotëve	D	420	420	420	520	620	620	800
Distanca në mes izolatorëve T.L.	E	265	265	265	265	265	265	300
Distanca në mes izolatorëve T.U.	F	100	100	100	120	120	140	220

KUSHTET TEKNIKE PËR PRODHIMIN E TRANSFORMATORIT TREFAZOR ENERGJETIK  
DISTRIBUTIV TIP TEDA ME KONZERVATOR SIPAS STANDARDIT IEC 60076

Fuqia nominale	kVA	50	100	160	250	400	630	1000
Tensioni nominal	kV	10/ 0,4 kV						
Rregullimi		2 x 2,5%						
Frekuenca	Hz	50 Hz						
Grupa vektoriale e lidhjes		Yzn5	Yzn5	Yzn5	Dyn5	Dyn5	Dyn5	Dyn5
Toleranca ne raportin e transformimit	%	4	4	4	4	4	4	6
Humbjet dhe rryma e punes pa ngarkese W	W	150	250	360	520	740	1050	1330
Humbjet me ngarkese dhe tensioni I lidhjes se shkurter W	W	850	1450	1850	2600	3650	5200	9000
Lloji I ftohjes		ONAN						
Sasia e vajit	kg	110	125	175	210	245	365	615
Pesha e tersishme	kg	460	570	820	950	1260	1880	2760

DIMENSIONET E TRANSFORMATORIT TEDA

Lartesia	C	1200	1295	1300	4120	1475	1600	1810
Gjeresia	B	530	540	660	640	750	910	1050
Gjatesia	A	900	1000	1150	1180	1400	1600	1840
Distanca ne mes rroteve	D	420	420	520	520	620	620	800
Distanca ne mes izolatoreve T.L.	E	265	200	200	200	200	200	300
Distanca ne mes izolatoreve T.U.	F	100	100	100	120	120	140	220

**PËRSHKRIMI I PRODHIMIT**

**Bërthama magnetike:** Është e prodhuar nga llamarina shumë kualitative magnetike me humbje shumë të vogla të energjisë. Fletët e llamarinës janë të prera dhe të puthitura shumë mirë në mesë veti çka mundësojnë punë pa zhurmë dhe kualitet të lartë të humbjeve minimale në punë pa dhe me ngarkesë. Bërthama është e lidhur dhe e shtrënguar në atë mënyrë që gjatë transportit dhe shfrytëzimit garanton stabilitet dhe padëmtueshmëri.

**Mbështjellat:** Janë të prodhuara nga bakri i rumbullakët për TL dhe nga bakri profil ose foli alumini për TU. Teli i rumbullakët i bakrit është nga izolimi i klasës "F", kurse bakri i profiluar është i izoluar me letër për izolim të transformatorëve. Bërthama në tërësi në mes të shtresave është e izoluar me letër izoluese, ngjitës special dhe e kufizuar me preshpan izolues. Ndarja në mes bërthamave dhe mbështjellave është e kryer me preshpan izolues të fortë ose kuti nga plastika enkas e prodhuar për tipet adekuate. Të gjitha së bashku pas montimit thahen në furrën për tharje e cila mundëson eliminimin e lagështisë në tërësi. Mbushja me vaj e transformatorit bëhet përmes makinës për filtrim dhe vakuumim e cila mundëson vakuumimin e transformatorit të prodhuar. Ndarja e shtresave të mbështjellave e kryer me kanale të cilat mundësojnë depërtimin e vajit për ftohje mundëson punë normale edhe për temperatura të larta të cilat mund të paraqiten në transformator nga puna dhe atmosfera. Izolimi i tillë pa gazëra është rezistent në presionet e punës dhe kushteve atmosferike.

**Izolatorët:** Lidhëset e TL dhe TU janë të përquara nëpër izolatorët e porcelanit të vendosura në kapakun e kazanit të transformatorit të cilat i përmbushin kushtet e standardit DIN 42530 dhe DIN 42531. Montimi dhe demontimi i tyre kryhet lehtë pa pasë nevojë të hapet kazanit. Janë të montuara dhe të shtrënguara në atë mënyrë që të mos lejohet derdhja e vajit për ftohje si dhe lëvizja në ndonjë drejtim i cili do të dëmtonte ose vënte jashtë përdorimit transformatorin.

**Kazani:** Është i prodhuar nga llamarina e valëzuar, i salduar me salduese CO<sub>2</sub>, rreth e përçark i brinjëzuar. Pasi të mbyllet transformatori, kazanit mbushet me vaj i cili depërton në brinjët e kazanit dhe gjer në gjysmën e konzervatorit. Transformatori është projektuar në atë mënyrë që gjatë punës normale në kazan formohet presioni nga 20 e gjer në 25 kPa. Kapaku i kazanit është i mbyllur me bulona; nënshtresa dhe dado. Transformatori i prodhuar me konzervator mundëson punë normale të tij në kushtet e temperaturave të rrethinës punuese prej -40 C e gjer në +40 C. Kazani është i izoluar me ngjyrë antikorozeve dhe i lyer më ngjyrë e cila rrjedh mbi kazan kurse me shpric bëhet rrafshimi i ngjyrës, e të gjitha këto sigurojnë shtresë të ngjyrosjes prej 60 mikronëve. Në fund të kazanit janë të montuara rrotat të cilat mundësojnë lëvizjen e transformatorit në dy drejtime të dëshiruara.



# TË DHËNAT PËR POROSI

Nëse përcaktoheni për prodhimin tonë dhe dëshironi të furnizoheni nga ne, ju sugjerojmë që porosia juaj duhet të përmbajë kërkesat të cilat duhet të definojnë:

**Tipin e transformatorit,  
Fuqinë nominale,  
Tensionin nominal,  
Grupa vektoriale e lidhjes,  
Humbjet në punën pa ngarkesë,  
Humbjet në punën dhe rrymat me ngarkesë  
Paisjet perçjellëse.**

Për porositë jashtësërike të transformatorëve duhet të cekni edhe:

**Frekuencen  
Tolerancën në rregullim të tensionit,  
Temperaturën më të lartë të rrethinës,  
Lartësinë mbidetare (mbi 1000m)  
Për lidhje në seri duhet cekur (fuqia, grupa vektoriale e lidhjes, ngarkesa e lidhjes së shkurtër dhe toleranca e rregullimit të tensionit me të cilat do të punojnë transformatorët së bashku).**



**26 VITE // 1989-2015**

**"AULONA" Sh.p.k. Rr. At Shtjefen Gjeqovi 24, Gjakovë, Kosovë, T&F +381 390 325 755,  
Mob: +377 44 133 803 ; 044 133 805 www.aulona-ks.com, e-mail: info@aulona-ks.com**